

Numri i lëndës: 2019:117694

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05460834

**C.nr.43/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË V.**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.S. nga V., rr. “Flaka e Janarit” p.n. kundër të paditurve G.S., S.S., të cilët i përfaqëson me autorizim i padituri S.M.dhe i padituri S.M., të gjithë nga V. rr. “E UÇK-së” për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 12,835.50 euro, pas mbajtjes së seancë gjyqësore në prani të palëve ndërgjyqëse, me datë 14.03.2024, bie këtë:

### **A K T G J Y K I M** **NË BAZË TË POHIMIT**

**I. MIRATOHET e bazuar** kërkesëpadia e paditësit A.S. nga V., **VËRTETOHET** se i njëjti është pronar ekskluziv i ngastrës kadastrale nr.**2726-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1519 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Bejram”, në zonën kadastrale V., e evidentuar në emër të paditurve G.S., S.S., S.M.dhe S.M., si bashkëpronarë juridikë secili me nga ¼, e pjesës ideale të pronës, në bazë të shitblerjes.

**OBLIGOHEN** të paditurit G.S., S.S., S.M.dhe S.M., që këtë të drejtë t`ia njohin paditësit A.S., të përmbahen dhe ta durojnë që në bazë të këtij aktgjykimi këtë ngastër ta regjistroj në emër të vetë dhe ta shfrytëzoj pa u penguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojën e përmbarimit të dhunshëm.

Ky aktgjykim për Zyrën Kadastrale Komunale në V., paraqet bazë të mjaftueshme juridike, ta bëjë ndryshimin në regjistrat kadastrale në bazë të tij, 15 ditë pas plotfuqishmërisë së të njëjtit.

Ky Aktgjykim është i plotfuqishëm nga data e vendosjes me 14.03.2024.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **A r s y e t i m**

Paditësi A.S. nga V. rr. “Flaka e Janarit”, në padinë dhe kërkesëpadinë e tij, të dorëzuar në gjykatë me datë 07.02.2019, ka kërkuar nga Gjykata që të vërtetohet e drejta e pronësisë së tij në bazë të shitblerjes, në ngastrën kadastrale nr.2726-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1519 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Bejram”, në zonën kadastrale V., e evidentuar në emër të paditurve G.S., S.S., S.M.dhe S.M., si bashkëpronarë juridikë secili me nga ¼, e pjesës ideale të pronës, Përmes padisë paditësi ka theksuar se këtë paluajtshmëri e kishte blerë nga të paditurit S.S., S.M.dhe S. Zagorga nga V., me datë 15.04.2000, me të cilët kishtelidhur dhe hartuar kontratën private mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, ku ndaj të njëjtëve si të paditur e ka përmbushur obligimin kontraktues, duke iu paguar çmimin e kontraktuar dhe duke hy në posedim dhe shfrytëzim të saj,

të cilin posedim nuk më është kontestuar deri më tani as nga të paditurit, familjarët e tyre, apo nga cili do person i tretë eventual.

Gjykata të paditurve, konform dispozitave të nenit 394 të LPK-së, iu ka dorëzuar aktvendimin për përgjigje në padi, me gjitha shkresat e lëndës, mirëpo asnjëri nga të paditurit nuk kishte dhënë përgjigje në padi.

Gjykata e ka caktuar seancën përgatitore për datën 23.02.2024, në të cilën seancë përveç paditësit, në seancë ishte paraqitur edhe i padituri S.M., i cili e kishte sjell në gjykatë edhe autorizimin e noterizuar, përmes së cilit ishte autorizuar nga të paditurit S.S.dhe motra e tij e paditura G.S.e lindur S., por në seancë edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt nuk ishte paraqitur i padituri S.M..

Paditësi A.S. kishte mbetur tërësisht pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke propozuar që t'i njihet e drejta e pronësisë në ngastrën kontestuese, duke përsëritur se të njëjtën e kishte blerë nga të paditurit dhe e kishte paguar në tërësi çmimin e kontraktuar, duke ia paguar shitësve/të paditurve shumën prej 1,690 marka gjermane (DM) për një ari, apo në total shumën prej 25,671.10 DM. Kishte theksuar se kontrata ishte lidhur në prani të dëshM.ëve S.H., S.A.dhe D.A.nga V.. Në fund kishte thënë se nga ajo kohë kishte hy në posedim dhe shfrytëzim të ngastrës së kontraktuar, të cilin posedim askush nuk ia ka kontestuar deri më tani.

I padituri M. S. nga V., ishte feklaruar se e pranon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, sikur edhe thënie e tij në seancë, duke pranuar se ai me vëllezër dhe motrën e tij ia kishin shitur A.S.t ngastrën me nr.2726-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1519 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur "Bejram", në zonën kadastrale V., për shumën e përgjithshme prej 25,671.10 DM, duke pranuar se kjo shumë iu ishte dorëzuar shitësve nga blerësi, duke propozuar që atë si i paditur dhe autorizuesit e tij Svetlanën dhe Stojadinin mos t'i ftoj në seanca tjera eventuale. Kishte propozuar që gjykata lirisht të bie aktgjykim në bazë të pranimit.

I njëjti ishte shprehur se në rast se gjykata ia njuh të drejtën e pronësisë paditësit, ai nuk do të ushtrojë ankesë, që do të thotë se e paralajmëroi gjykatën se heq dorë nga e drejta e ankesës, duke mos ia kontestuar të drejtën paditësit se mundet edhe ta regjistroj në regjistrin kadastral në V..

Në seancën kryesore me datë 14.03.2024, përkundër faktit të deklaruar nga i padituri S.M. që mos të paraqitet në seanca eventuale tjera, ai ishte paraqitur, sikur edhe i padituri S.M..

Edhe i padituri S.A.ishte shprehur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në prova dhe e themeltë, duke e njoftuar gjykatën se nuk ia konteston kërkesëpadinë paditësit, por duke propozuar gjykatës që sa i përket ngastrës kontestuese nr.2726-0, ZK V., gjykata të bie aktgjykim në bazë të pranimit, sikur edhe parafolësi i më parshëm, i padituri M. S..

Të paditurit absolutisht janë shprehur në favor të kërkesës së paditësit, duke mos ia kundërshtuar as kontestuar kërkesën, madje duke i propozuar gjykatës që, për kërkesën e tillë të vendoset me aktgjykim pohues, duke mos ia kontestuar paditësit të drejtën e regjistrimit të tij në regjistrin kadastral, që do të thotë se kanë paralajmëruar se heqin dorë edhe nga e drejta për të ushtuar ankesë.

Paditësi, si prova lëndës - padisë i ka bashkangjitur:

Certifikatën pronësore me numër 215/2019, me ngastrën nr.2726-0, e datës 05.02.2019, e regjistruar në emër të paditurve G.S., S.S., S.M.dhe S.M., si bashkëpronarë juridikë secili me nga ¼, e pjesës ideale të pronës dhe Kontratën private për shitblerjen e paluajtshmërisë e lidhur me date 15.04.2000, ndërmjet palëve kontraktuese, tani ndërgjyqësve.

Meqenëse, të paditurit e kanë pranuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, por edhe provat në lëndë janë në harmoni të plotë me themelësinë e kërkesëpadisë, gjykata pa u lëshuar në shqyrtimin e mëtejme të çështjes, konform nenit 148, të LPK-së, bie këtë aktgjykim në bazë të pranimit.

Është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË V.

C.nr. 43/2019

Më: 14.03.2024

G j y q t a r i

Raif Fazliu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Palët në procesverbal janë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës.